



Solvent Rating shpk

Rr. Reshit Collaku, Pall. Shallvare, Apt.44

Tiranë

Shqipëri

Email: info@boniteti.al

www.boniteti.al

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PËRDORIMIT TË PORTALIT BONITETI.AL

Mbajtësi i portalit Boniteti.al është kompania Solvent Rating shpk, Rr. Reshit Collaku, Pall. Shallvare, Apt.44, Tiranë (në vijim: mbajtësi).

1. Objekti

Përmbajtja e kushteve të përgjithshme të portalit Boniteti.al (në vijim: kushtet e përgjithshme) është përdorimi i të dhënave të cilat i përmban Boniteti.al dhe të shërbimeve të përshkruara në udhëzimet dhe broshurat të cilat janë pjesë e Boniteti.al

2. Bazë

Mbajtësi garanton publikim dhe mirëmbajtjen e të dhënave në portalin Boniteti.al në formën e bazës së të dhënave që janë pjesë e Boniteti.al

3. Disponueshmëria e përmbajtjes

Mbajtësi mirëmban portalin Boniteti.al në mënyrë që portali të jetë i disponueshëm online për përdorim 24 orë në ditë, çdo ditë gjatë vitit kalendarik. Mbajtësi e ka të drejtën e ndërprerjes së shkurtër të aksesit në portalin Boniteti.al për shkak të arsyeve teknike të mirëmbajtjes dhe të zëvendësimit të pajisjeve. Për shkak të mirëmbajtjes së portalit Boniteti.al mbajtësi ka të drejtën e pezullimit më të gjatë të aksesit në faqen Boniteti.al, por sipas rregullave, vetëm gjatë ditëve të fundjavës.

4. Mënyrat e aksesit

Mënyrat e aksesit dhe përdorimit të përmbajtjes janë të rregulluara me udhëzimet dhe broshura të tjera të Boniteti.al me si dhe në faqen e internetit Boniteti.al. Për çdo ndryshim të mundëshëm të mënyrës së aksesit dhe përdorimit të përmbajtjes, mbajtësi do të informojë në faqen e tij të internetit Boniteti.al për fjalëkalimin individual.

5. Përdorimi i portalit Boniteti.al

Përdorimi dhe aksesit në portalin Boniteti.al janë të garantuar 24 orë në ditë dhe çdo ditë gjatë një viti kalendarik me përjashtim të rasteve që janë përshkruar në pikën 3 të Kushteve të Përgjithshme. Mbajtësi rezervon të drejtën për të kufizuar ose ndërprerë mundësinë e përdorimit të portalit Boniteti.al për një fjalëkalim individual në rast të dyshimit për abuzim, që nënkupton shkelja e nenit 9 të Kushteve të Përgjithshme.

6. Rregullat e tjera të përdorimit

Për të siguruar përdorimin cilësor të portalit Boniteti.al përdoruesi është i detyruar të zbatojë dhe të respektojë të gjitha udhëzimet dhe rregullat e përdorimit të publikuara në faqen e internetit Boniteti.al, në udhëzime dhe broshura të tjera të Boniteti.al, ose në kuadër të modalitetit online.

Përdoruesi është i detyruar që me rasitin e çdo aksesit në faqen Boniteti.al do të përdorë emrin dhe fjalëkalimin e caktuar nga mbajtësi. Mbajtësi mban të drejtën e ndryshimit të fjalëkalimit që ia ka caktuar përdoruesit. Mbajtësi është i detyruar që në rastet e ndryshimit të mundëshëm të fjalëkalimit t'ia mundësojë përdoruesit përdorimin e papenguar dhe të vazhdueshëm të portalit Boniteti.al.

7. Fillimi i abonimit

Mbajtësi merr përsipër t'ia dergojë me postë të regjistruar emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin për aksesin në portalin Boniteti.al brenda pesë ditëve pune nga marrja e porosisë ose nga nënshkrimi i kontratës me përdoruesin.

Një porosi e vlefshme shtesë është porosia e fjalëkalimeve përmes emailit, në qoftë se kompania tashmë ka një abonim aktiv ose kontratën e nënshkruar. Si fillim i abonimit konsiderohet dita e nesërme pune, që vijon pas ditës kur përdoruesi ka marrë emrin dhe fjalëkalimin. Abonimi ose marrëdhënia kontraktuale lidhet për një periudhë njëvjeçare dhe vazhdon automatikisht nëse pala kontraktuese, përdoruesi, nuk e anulon me shkrim.

8. Çmimet e shërbimeve

Rreth listës së çmimeve të shërbimeve të Boniteti.al vendoset nga menaxhmenti i mbajtësit. Nëse përdoruesit në fillim të prosisë i caktohet më shumë se një fjalëkalim, përdorimi i faqes Boniteti.al ngarkohet në shumën dhe mënyrën e përshkruar në listën e çmimeve të shërbimit Boniteti.al.

9. Fjalëkalimi si sekret biznesi

Përdoruesi është i detyruar ta ruajë fjalëkalimin që ka marrë nga mbajtësi si një sekret pune dhe pranon që ky fjalëkalim do të përdoret vetëm nga një personi i autorizuar. Përdoruesi e merr përsipër dëmshpërblimin në rastet e përdorimit të paautorizuar të fjalëkalimit nga persona të treta.

Përdoruesi është i detyruar ta informojë mbajtësin në rastin e dyshimit se fjalëkalimi përdoret nga personi i paautorizuar. Mbajtësi menjëherë do të caktojë një fjalëkalim të ri pa pagesë për përdoruesin. Të gjitha shpenzimet e shkarkuara për arsye të keqpërdorimeve eventuale do të merren përsipër nga përdoruesi.

10. Përgjegjësia për përdorimin e rrjetit të komunikimit

Përdoruesi është i vetmi përgjegjës për përdorimin e modemit, pajisjeve të tjera dhe rrjetit të komunikimit në përputhje me rregullat, miratimet, lejet etj. Mbajtësi siguron pajisje të duhura vetëm nga ana e tij dhe nuk është përgjegjës për çdo lloj parregullsie ose paligjshmërisë së shkaktuar nga pajisjet e papërshatshme ose sjelljet e pahijshme të përdoruesit.

Mbajtësi nuk është përgjegjës për ndërprerjen në aksesin në faqen Boniteti.al që është shkaktuar me fajin e kompanisë e cila ia siguron internetin përdoruesit. Mbajtësi do të bëjë gjithçka që është e mundur nga ana e tij dhe do të këshillojë përdoruesin në lidhje me përdorimin e pajisjeve të komunikimit. Mbajtësi nuk është përgjegjës për asnjë dëmtim ose shqetësim direkt apo indirekt që mund të lindë nga pengesat eventuale teknike ose ndërprerja e punës së Boniteti.al.

11. Ndihmë për përdorimin e Boniteti.al

Mbajtësi ia siguron ndihmën e vazdhueshme dhe këshilla në lidhje me përdorimin e portalit Boniteti.al, me telefon, faks ose email.

12. Përgjegjësia për përdorimin e të dhënave

Megjithëse mbajtësi është i bindur se të gjitha të dhënat që ndodhen në faqen e Boniteti.al janë cilësore, të sakta dhe të përditësuara, mbajtësi nuk është përgjegjës për asnjë dëm direkt apo indirekt që mund të rezultojë nga përdorimi i të dhënave nga faqja Boniteti.al ose për shkak të gabimeve të mundshme ose për shkak të të dhënave jo të sakta që mund të gjenden në faqen Boniteti.al.

Mbajtësi deklaron se të gjitha të dhënat dhe shërbime të tjera që ofton Boniteti.al janë në dispozicion në formën ekzistuese dhe nuk garanton rregullsinë e tyre dhe përdorimin e tyre në punën e përdoruesit si dhe qëllimin e tyre.

13. Mbrojtja e të drejtave të autorit

Përdoruesi pranon se është i njoftuar me udhëzimet dhe rregullat e përdorimit të faqes Boniteti.al dhe se në pjesën e faqes Boniteti.al, në të cilën është e mundur plotësimi i informacioneve do të respektojë rregullat dhe udhëzimet, kryesisht të lidhura më mbrojtjen e të drejtave të autorit.

Përdoruesi deklaron se të gjitha informacionet që do të dërgojë në faqen Boniteti.al do të përjashtohen nga mbrojtja e të drejtave të autorit, dhe se do të jenë të disponueshme për të gjithë, se do të jenë e mira publike (public domain) ose shareware, me përjashtim të atyre për të cilat autori në mënyrë eksplicite kërkon ndryshe. Në të njëjtën kohë, është e ndaluar të shkarkohen programe komerciale që janë të mbrojtura me të drejtën e autorit nga faqja Boniteti.al

14. Kufizimet në përdorimin e të dhënave

Përdoruesi pajtohet që informacioni i marrë nga faqja Boniteti.al do të përdoret vetëm për qëllimin e tij dhe se nuk do ta shpërndajë më tej për një qëllim që nuk është në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe pa pëlqim eksplicit të mbajtësit. Në vend të parë nuk do të përdorë dhe kopjojë të dhënat individuale dhe të dhënat që ndodhen në bazat dhe pjesët e bazave të Boniteti.al në ndonjë kompjuter tjetër ose ndonjë pajisje tjetër me qëllim të përdorimit të këtyre të dhënave, të rregulluara dhe të renditura në mënyrë të njëjtë apo të ngjashme si në bazat e Boniteti.al.

Përdoruesi është përgjegjës për dëmet që rrejdin nga përdorimi i të dhënave nga faqja Boniteti.al i cili është në kundërshtim me kushtet e përdorimit dhe termat e kushteve të përgjithshme.

15. Përfundimi i abonimit

Nëse nuk është rënë dakord ndryshe, abonimi është lidhur në një periudhë prej një viti nga data e lidhjes së kontratës. Fjalëkalimet e porositura nuk mund të anulohen para skadimit të abonimit ose para skadimit të kontratës.

Mbajtësi ka të drejtën e ndërprerjes së marrëveshjes në rastin e mospagesës së detyrimeve. Përdoruesi njoftohet tre ditë përpara me shkrim dhe në këtë afat duhet të paguajë detyrimet që ka ndaj mbajtësit. Përndryshe, përdoruesi është i detyruar të paguajë pjesën proporcionale të abonimit për periudhën e mëparshme që ka përdorur shërbimin.

Përdoruesi mund të anulojë abonimin për të gjitha fjalëkalimet ose vetëm për një pjesë të fjalëkalimeve 30 ditë para skadimit të abonimit, ose para skadimit të kontratës. Pasoja e shekljes së ndonjë prej kushteve të përgjithshme është ndërprerja e abonimit me skadimin e muajit pasardhës. Mbajtësi në këtë rast do ta heqë fjalëkalimin në ditën e parë të muajit në vijim.

16. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve të mundshme do të jetë kompetente Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.